



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2023 PËR AMBALAZHIN DHE
MBETURINAT E AMBALAZHIT**

-
1. Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 07/2023 për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit, është miratuar në Mbledhjen e 154-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/154, të datës 09.08.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare Nr.29 e datës 1 shtator 2022), nenit 8 paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/22 e datës 18 nëntor 2022), si dhe nenit 19 paragrafi 6 nën-paragrafi 2 të Rregullores Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë (Gazeta Zyrtare Nr.15 e dt. 12 shtator 2011),

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 07/2023 PËR AMBALAZHIN DHE MBETURINAT E AMBALAZHIT

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e kushteve, procedurave, përgjegjësi dhe detyrimeve për prodhuesit, importuesit, shitësit dhe palët tjera, për menaxhimin e ambalazhit dhe mbeturinat e ambalazhit, duke ndërmarrë masat që synojnë:

- 1.1. Parandalimin e prodhimit të mbeturinave të ambalazhit;
- 1.2. Rritjen e nivelit të ripërdorimit të ambalazhit;
- 1.3. Riciklimin dhe format e tjera të përpunimit të mbeturinave të ambalazhit;
- 1.4. Zvogëlimin e deponimit përfundimtar të këtyre mbeturinave;
- 1.5. Kontributin në tranzicionin drejt një ekonomie qarkore.

2. Udhëzimi Administrativ është pjesërisht në përputhje me:

- 2.1. Direktivën Nr. 1994/62 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 dhjetor 1994 e konsoliduar për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit; dhe
- 2.2. Direktivën Nr. 2019/904 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 qershor 2019 për Zvogëlimin e Ndikimit të Produkteve të Caktuara Plastike në Mjedis.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për ambalazhin të vendosur në tregun e Republikës së Kosovës dhe të gjitha mbeturinat e ambalazhit, qofshin ato të përdorura ose krijuara në nivel: industrial, komercial, zyre, dyqane, shërbime, të ekonomive familjare, apo çfarëdo niveli tjetër, pavarësisht nga materiali i përdorur, përveç nëse me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet ndryshe.

2. Ky Udhëzim Administrativ plotëson kërkesat ekzistuese të kualitetit për ambalazhin lidhur me sigurinë, mbrojtjen e shëndetit dhe higjienën e produkteve të ambalazuara apo kërkesat për transportimin e tyre, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

1.1. **Ambalazh** – të gjitha produktet e prodhuara nga çfarëdo materiali të çfarëdo natyre që shfrytëzohet për mbajtjen, mbrojtjen, trajtimin, bartjen dhe prezantimin e mallrave, nga lënda e parë deri te prodhimi i përpunuar, nga prodhuesi deri te shfrytëzuesi ose konsumatori. Ambalazh janë edhe artikujt e pakthyeshëm të përdorur për qëllime të njëjta. Ambalazhi përbëhet vetëm nga:

1.1.1. Ambalazhi i shitjes ose ambalazhi parësor, që nënkupton ambalazhin e konceptuar në mënyrë që të përbëjë një njësi shitjeje te përdoruesi ose konsumatori i fundit në pikën e blerjes;

1.1.2. Ambalazhi i grupuar ose ambalazhi dytësor, që nënkupton ambalazhin e konceptuar në mënyrë që në pikën e blerjes të përbëjë, një grupim të një numri të caktuar njësisish shitjeje nëse ky i fundit i shitet si i tillë përdoruesit ose konsumatorit të fundit ose nëse shërben vetëm si një mjet për t'i rimbushur raftet në pikën e shitjes; mund të hiqet nga produkti pa ndikuar në karakteristikat e tij;

1.1.3. Ambalazhi për transport ose ambalazhi tretësor, që nënkupton ambalazhin e konceptuar në mënyrë që ta lehtësojë trajtimin dhe transportin e një numri njësisish shitjesh ose ambalazheve të grupuara për ta parandaluar dëmtimin fizik dhe dëmtimin gjatë transportit. Ambalazhi për transport nuk përfshin kontejnerët e rrugëve, hekurudhave, anijeve dhe ajrit;

1.1.4. Përkufizimi i ambalazhit bazohet më tej në kriteret e përcaktuara më poshtë. Produktet e renditura në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ janë shembuj ilustrues të zbatimit të këtyre kriterëve:

1.1.4.1. produktet konsiderohen si ambalazh nëse përmbushin përkufizimin e lartpërmendur pa paragjykuar funksionet e tjera për të cilat mund të shërbej ambalazhi,

përveç nëse produkti është pjesë përbërëse e një produkti dhe duhet ta mbaj, mbështet ose ruajë atë produkt gjatë gjithë jetës së tij dhe të gjithë elementet synohen të përdoren, konsumohen ose hedhur së bashku;

1.1.4.2. produktet e dizajnuar dhe të destinuar për t'u mbushur në pikën e shitjes dhe produktet për t'u hedhur që shiten, mbushen ose janë të projektuar dhe të destinuar për t'u mbushur në pikën e shitjes konsiderohen ambalazh, me kusht që të përmbushin një funksion të ambalazhit;

1.1.4.3. komponentët e ambalazhit dhe elementet ndihmëse të integruara në ambalazh konsiderohen si pjesë e ambalazhit në të cilin janë integruar. Elementet ndihmëse të varur drejtpërdrejt në, ose të lidhur për, një produkt dhe që kryejnë një funksion të ambalazhit konsiderohen që janë ambalazh, përveç rasteve kur ato janë pjesë përbërëse e këtij produkti dhe të gjithë elementet synohen të konsumohen ose hedhen së bashku.

1.2. **Material i ambalazhit** - materiali nga i cili prodhohet ambalazhi, si: letra, kartoni, qelqi, plastika, druri, metali, porcelani, qeramika, fijet e tekstilit dhe materiale të tjera;

1.3. **Plastikë** - një polimer, të cilit mund t'i jenë shtuar aditivë ose substanca të tjera, dhe i cili është në gjendje të funksionojë si përbërësi kryesor strukturor i qeseve mbajtëse;

1.4. **Plastikë e okso-degradueshme** – materiale të plastikës që përfshijnë aditivë të cilat, përmes oksidimit, shpijnë në fragmentim të materialit të plastikës në mikro-fragmente ose në dekompozim kimik;

1.5. **Plastikë e biodegradueshme** – plastikë që mund t'i nënshtrohet dekompozimit fizik ose biologjik, ashtu që përfundimisht dekompozohet në dioksid karboni, biomasë dhe ujë;

1.6. **Qese plastike mbajtëse** - qese mbajtëse, me ose pa dorezë, të prodhuara nga plastika, të cilat i jepen konsumatorit në pikën e shitjes së mallrave ose produkteve;

1.7. **Qese plastike mbajtëse me peshë të lehtë** - qese plastike mbajtëse me dorëza me trashësi muri nën pesëdhjetë (50) mikron;

1.8. **Qese plastike mbajtëse me peshë shumë të lehtë** - qese plastike mbajtëse pa dorëza me një trashësi muri nën pesëmbëdhjetë (15) mikron, të cilat kërkohen për qëllime higjiene ose ofrohen si ambalazh parësor për ushqim të pa ambalazhuar kur kjo ndihmon për ta parandaluar humbjen e ushqimit;

1.9. **Qese plastike mbajtëse të okso-degradueshme** - qese plastike mbajtëse të bëra nga materiale plastike që përfshijnë aditivë të cilët katalizojnë fragmentimin e materialit plastik në mikro-fragmente;

1.10. **Ambalazhi i ripërdorshëm** – ambalazhi i cili pas zbrazjes së produktit, rimbushet ose ripërdoret për të njëjtin qëllim për të cilin është konceptuar, me ose pa mbështetjen e produkteve ndihmëse të pranishme në treg që mundësojnë rimbushjen ose ripërdorimin e ambalazhit;

1.11. **Ambalazh kompozitë** – ambalazh i bërë nga dy ose më shumë shtresa materialesh të ndryshme që nuk mund të ndahen me dorë dhe formojnë një njësi të vetme integrale që përbëhet nga një hapësirë e brendshme dhe një mbyllje e jashtme, që mbushet, ruhet, transportohet dhe zbrazet si e tillë;

1.12. **Grumbullim i ndarë i ambalazhit mbeturinë** - veprimet e organizuara të grumbullimit, ndarjes, klasifikimit dhe transportit të ambalazhit mbeturinë;

1.13. **Trajtimi i mbeturinave nga ambalazhet** - procedura në të cilën, gjatë procesit mekanik, fizik, termik, kimik ose biologjik, përfshirë grumbullimin e ndarë, karakteristikat e mbeturinave ndryshohen me qëllim që të reduktohet sasia e tyre, duke lehtësuar, në këtë mënyrë, menaxhimin dhe përmirësimin e përdorimit të tyre;

1.14. **Ripërdorimi i ambalazhit** – përdorimi më shumë se një herë i ambalazhit brenda ciklit të vetë jetësor për të njëjtin qëllim për çka është destinuar;

1.15. **Ambalazhues** – personi fizik ose juridik i cili prodhon ose importon ambalazh dhe e nxjerr në treg. Gjithashtu, ambalazhues konsiderohet personi që e vendos produktin në ambalazh dhe e nxjerr në treg. Ambalazhuesi i cili i vendos ambalazhet me pije në treg për SRD është prodhues;

1.16. **Prodhues** - personi fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon dhe nxjerr në treg për qëllim të aktivitetit të tij tregtar produkte të vendosura në ambalazh. Sa i përket SRD-së, prodhues konsiderohet prodhuesi i pijeve të ambalazuara që është objekt i SRD-së, si dhe prodhuesi konsiderohet ose pronar i markës për produktet e markës në Kosovë, ose importues për produktet e markuara jashtë Kosovës;

1.17. **Prodhues i vogël** – personi fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon dhe nxjerr në treg për qëllim të aktivitetit të tij tregtar produkte të vendosura në ambalazh, nën sasitë e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ;

1.18. **Shitës** – personi fizik ose juridik i cili i shet konsumatorit mallin me ambalazh;

1.19. **Konsumator** – personi i cili e shfrytëzon produktin nga ambalazhi si përdorues i fundit;

1.20. **Operatori ekonomik** - furnizuesi, prodhuesi, ambalazhuesi përdoruesi, importuesi, shpërndarësi, autoriteti dhe organizata që ka të bëjnë me ambalazhin;

1.21. **Qendër grumbulluese e mbeturinave nga ambalazhi** - qendër e pajisur me leje përkatëse mjedisore ku dërgohen mbeturinat e ambalazhës të riciklueshme për të realizuar ndarjen e mëtejshme e të klasifikuar sipas llojeve të mbeturinave, si ambalazheve të letrës e kartonit, të plastikës, të qelqit, metalit, etj.;

1.22. **Transportuesi** - personi fizik ose juridik i cili merret me transportin e mbeturinave nga ambalazhi ose mbeturinave komunale;

1.23. **Magazinin i ambalazhit mbeturinë** – ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim;

1.24. **Marrëveshje vullnetare** - marrëveshja e përfunduar ndërmjet autoriteteve publike kompetente nga njëra anë dhe subjekteve ose sektorëve ekonomikë të interesuar nga ana tjetër, e hapur për të gjitha palët që kanë interesa të ligjshëm dhe marrin përsipër të plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje dhe objektivat e përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ;

1.25. **Sistem i Rimbursimit të Depozitave (SRD)** - sistemi i rimbursimit të depozitave, ose një tarifë e depozituar si paradhënie ose skemë e rimbursimit të depozitave, ose shtesë mbi çmimin e një produkti kur blihet dhe zbritje kur rimbursohet p.sh. pagesa e një shume parash, depozitash për ambalazhe të riciklueshme siç janë shishet, kanaçet, etj. që është e rimbursueshme kur kthehet ambalazhi i ripërdorshëm ose i riciklueshëm;

1.26. **Depozitë** - shuma specifike monetare në lidhje me ambalazhin e produktit, qëllimi i së cilës është të sigurojë që mbeturinat e ambalazhit t'i kthehen Administratorit dhe të menaxhohen në përputhje me prioritetet e menaxhimit të mbeturinave;

1.27. **Pronar i markës** - personi i cili, në kuadër të tregtimit, biznesit, zanatit ose profesionit, vendos një emër, markë tregtare ose shenjë tjetër dalluese në një produkt të SRD ose ambalazh të SRD-së me anë të së cilës personi konsiderohet të jetë prodhues ose produktit të SRD-së, dhe “brendimi” duhet të interpretohet në përputhje me rrethanat;

1.28. **Zona e shitjes** - ajo pjesë e ambienteve të një ndërmarrjeje, e cila përdoret për të shitur dhe ekspozuar produkte, dhe që përfshin sipërfaqen totale të qasshme nga klientët, duke përfshirë sallat e montimit, hapësirën e banakut, hapësirën e dritareve dhe hapësirën pas sporteleve të përdorura nga shitësi; zona e shitjes nuk përfshin zyrat, depot e magazinimit dhe përgatitjes, punishtet, shkallët ose tualetet;

1.29. **Tarifë e trajtimit** - Tarifa e paguar për shitësit me pakicë për marrjen dhe pagesën e depozitës, renditjen dhe ruajtjen e ambalazheve të shpaguara të pijeve. Tarifat e trajtimit mbulojnë kostot direkte të personelit, hapësirës dhe materialit të ambalazhit të nevojshëm për të trajtuar ambalazhet e pijeve;

1.30. **Ministria** – Ministria përkatëse për Mjedis;

1.31. **Agjencia** – Agjencia përkatëse për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

1.32. **Administratori** - Organizata përgjegjëse për funksionimin e SRD-së;

1.33. **Tarifa e prodhuesit** - tarifa e arsyeshme e paguar nga prodhuesi tek administratori për çdo ambalazh të pijeve që janë pjesë e SRD-së dhe që vendosen në treg;

1.34. **Shitësit me pakicë** - përfshijnë hipermarketet, supermarketet, dyqanet të vogla, lokale dhe dyqanet tjera p.sh. kioska, pika karburanti që shesin kontejnerë të pijeve për konsumatorët dhe pranojnë ambalazhin e shpaguear për të cilin paguhet depozita;

1.35. **Makina Shitëse Kthyesë** - një pajisje e automatizuar që pranon kontejnerë të zbrazët të pijeve dhe lëshon një rimbursim për një shumë depozite të bashkangjitur në ambalazhin që është paguar më parë;

1.36. **Pika e kthimit** - një vend në të cilin një person qoftë blerësi i produktit të SRD-së apo ndonjë tjetër mund të kthejë ambalazhin e SRD-së dhe të marrë pagesën e një shume të barabartë me depozitën për çdo produkt të ambalazhit të SRD-së të kthyer;

1.37. **Operator i pikës së kthimit** - kushdo që ofron një shërbim që mbledh shishet e riciklueshme të përfshira në SRD dhe rimbursion depozitat e konsumatorëve;

1.38. **Depozita të pashlyera** - vlera e depozitave të paguara në ambalazhet e pijeve që nuk janë shpaguear të hedhura si mbeturina, të ricikluara përmes mjeteve të tjera ose të humbura.

2. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ shprehja “ambalazh” nënkupton edhe shprehjen “paketim” sipas Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

3. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ emrat e gjinisë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat e gjinisë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim.

KAPITULLI II DETYRIMET E PRODHIMIT, VENDOSJES NË TREG DHE PËRDORIMIT TË AMBALAZHËS

Neni 4 Kërkesat e përgjithshme

1. Prodhuesi është i detyruar të përdor teknikat më të mira në dispozicion për prodhimin e ambalazhit i cili mund të përdoret përsëri, përpunohet ose riciklohet ashtu që ndikimi i padëshiruar në mjedis nga ambalazhi dhe mbeturinat e tij të jetë në nivelin më të vogël të mundshëm.

2. Prodhuesi mund të vendos në treg ambalazhin vetëm nëse i përmbush kërkesat lidhur me përbërjen, shfrytëzimin, përpunimin, ripërdorimin ose riciklimin e ambalazhit mbeturinë, të përcaktuara në Shtojcën II të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 5 Përmbajtja e metaleve të rënda në ambalazh

1. Prodhuesi vendos në treg ambalazhin e prodhuar nga materiali, sasia e metaleve të rënda plumbi, kadmiumi, mercuri dhe kromi gjashtë valent (6^+) të të cilit nuk tejkalojnë vlerën njëqind (100)

ppm për kilogram të masës.

2. Paragrafi 1 i këtij neni, nuk zbatohet për ambalazhet nga qelqi me kristal prej plumbi, arkat plastike dhe paletat që dalin nga materiali i ricikluar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Prodhuesi është i detyruar të sigurojë dëshmi me të dhëna për sasinë e metaleve të rënda, të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, për secilin lloj të materialit të ambalazhit në të cilin ambalazhohen mallrat.

4. Dëshmia sipas paragrafit 3 të këtij neni është dokumenti apo çertifikata që ambalazhuesi e siguron nga prodhuesi.

Neni 6 **Shenjëzimi i ambalazhit**

1. Prodhuesi me shpenzime të veta shenjëzon ambalazhin e prodhimit të cilin e vendos në treg me shenjë e numrit dhe shkurtesës së materialit të ambalazhit, shenjë për riciklim dhe barkodin.

2. Përveç kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni, prodhuesi që në treg vendos ambalazhin kthyes të ripërdorshëm shenjëzon atë ambalazh edhe me shenjë për kthimin e ambalazhit.

3. Përveç kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni, qeset plastike shenjëzohen edhe me nivelin e trashësisë së përcaktuar në mikron, emrin e prodhuesit dhe vitin e prodhimit. Qesja e plastikes e biodegradueshme dhe kompostueshme shenjëzohet gjithashtu me numrin e çertifikatës përkatëse që vërteton se qesja plastike është e biodegradueshme dhe kompostueshme.

4. Në qeset plastike mbajtëse me peshë të lehtë me dorëza prej njëzetepesë (25) deri pesëdhjetë (50) mikron, vendoset:

4.1. shenja e numrit dhe shkurtesës së materialit të ambalazhit;

4.2. shenja për riciklim;

4.3. barkodi;

4.4. niveli i trashësisë së përcaktuar në mikron, dhe

4.5. viti i prodhimit.

5. Në qeset nga paragrafi 4 i këtij neni ndalohet vendosja e logos, markës tregtare, sloganit ose emrit të prodhuesit ose shitësit.

6. Kërkesat për shenjëzim nga paragrafi 1 dhe 3 i këtij neni nuk zbatohen për qeset plastike mbajtëse me peshë shumë të lehtë pa dorëza.

7. Shenjat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni përcaktohen në Shtojcën III të këtij Udhëzimi Administrativ.

8. Përveç kërkesave të paragrafit 1, produktet e ambalazuara që i nënshtrohen SRD-së shenjzohen edhe me shenjën e rimbursimit të depozitës dhe vlerën e depozitës. Forma dhe përmbajtja e këtyre shenjave përcaktohen nga Administratori.

9. Ambalazhi që i përket SRD-së duhet të njihet me shënim vizual dhe me njohje automatike nga makina.

10. Depozita nuk do të kthehet nëse ambalazhi në të cilin është vendosur depozita i mungon etiketa e depozitës ose nëse barkodi nuk është i qartë, ose nëse etiketa është e dëmtuar fizikisht.

11. Nëse etiketa e depozitës në ambalazhin në të cilin është vendosur depozita ndryshon, depozita kthehet për ambalazhin me etiketën e mëparshme brenda njëzetekatër (24) muajve nga data e hyrjes në fuqi të etiketimit të ri.

Neni 7

Objektivat për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë

1. Objektivat e përcaktuara për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë janë:

1.1. Deri më 31 dhjetor 2024, niveli i përdorimit vjetor nuk kalon njëqindetëtdhjetë (180) qese plastike mbajtëse me peshë të lehtë për person;

1.2. Deri më 31 dhjetor 2030, niveli i përdorimit vjetor nuk kalon dyzet (40) qese plastike mbajtëse me peshë të lehtë për person.

2. Në rast të mos arritjes së objektivave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Ministria mund të ndërmerri masa shtesë.

Neni 8

Masat për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë

1. Masat për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë janë:

1.1. Ndalohet prodhimi, importi dhe shitja në treg e qeseve plastike mbajtëse me peshë të lehtë me dorëza me trashësi nga zero (0) deri në njëzetepesë (25) mikron;

1.2. Ndalohet prodhimi, importi dhe shitja në treg e qeseve plastike mbajtëse të okso-degradueshme;

1.3. Qeset plastike mbajtëse me peshë shumë të lehtë pa dorëza vihen në treg pa tarifë prej zero pikë zero dy (0.02) euro dhe pa pagesë për konsumatorin;

1.4. Qeset plastike mbajtëse me peshë të lehtë me dorëza prej njëzetepesë (25) deri pesëdhjetë (50) mikron vihen në treg me një çmim shitjeje minimal detyruar prej së paku zero pikë zero pesë (0.05) euro që paguhet nga konsumatori, ku prej tyre zero pikë zero dy (0.02) euro tarifë kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës;

1.5. Për qeset plastike mbajtëse me dorëza mbi pesëdhjetë (50) mikron nuk do të vendoset çmim shitjeje minimal detyruar e as tarifë prej zero pikë zero dy (0.02) euro;

1.6. Për qeset e plastikës biodegraduese të kompostueshme të çfarëdo madhësie dhe trashësie, me një certifikatë përkatëse që vërteton që qeset e plastikës janë nga materiali i biodegradueshëm dhe i kompostueshëm, nuk do të vendoset çmim shitjeje minimal detyruar e as tarifë prej zero pikë zero dy (0.02) euro.

2. Çdo qese plastike mbajtëse me peshë të lehtë e shitur, për të cilën zbatohet çmimi minimal detyruar, duhet të evidentohet në kuponin fiskal i cili i lëshohet konsumatorit nga shitësi.

3. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ, ndalohej vendosja e: llogos, markës tregtare, slloganit, emrit të prodhuesit ose shitësit, në qese plastike mbajtëse me peshë të lehtë me dorëza prej njëzetepesë (25) deri pesëdhjetë (50) mikron.

Neni 9

Detyrimet e prodhuesve sa i përket SRD-së

1. Për të siguruar funksionimin e duhur të SRD-së, prodhuesit e ambalazheve duhet:

1.1. Të mbajnë shënime të veçanta kontabël për çmimin e pijeve, tarifën e trajtimit dhe shumën e depozitës;

1.2. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e njoftimit për fillimin e veprimtarisë, të kërkojë nga Administratori lidhjen e kontratës për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij neni;

1.3. Të regjistrojnë ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së para se të vendosen në treg;

1.4. T'i paguajë Administratorit tarifën e arsyeshme prodhuesit e cila përfshinë depozitën dhe tarifën për trajtimin e ambalazhit për pijet që i vendos në treg e që janë subjekt i SRD-së, për periudhën e vitit kalendarik të përcaktuar nga kontrata e lidhur me Administratorin;

1.5. Të mbajnë evidencë për ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së dhe t'ia raportojë këto të dhëna Administratorit;

1.6. Të sigurojë çdo informacion të kërkuar nga Administratori në lidhje me detyrimet e prodhuesit;

1.7. Të njoftojë Administratorin për çdo ndryshim në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e ndryshimit;

1.8. Të njoftojë Administratorin me shkrim nëse prodhuesi dëshiron të anulojë regjistrimin ose ka pushuar të jetë prodhues në atë vit përkatës;

1.9. Të mbledhë dhe të mbajë për të paktën pesë (5) vite nga data në të cilën është mbledhur informacioni në një regjistër të informacionit;

2. Informacioni për regjistrin tregon:

2.1. Numrin e produkteve të SRD-së të vëna në dispozicion fillimisht nga ai prodhues për t'u tregtuar, ofruar për shitje ose shitur për qëllime të shitjes me pakicë në Kosovë;

2.2. Nëse ambalazhi i SRD-së në të cilën gjendeshin ose shiteshin këto produkte të SRD-së, ishte bërë nga plastika PET, qelqi ose alumini.

Neni 10 Ambalazhi i ripërdorshëm

1. Prodhuesi që vendos në treg ambalazhin e ri përdorshëm përmes depozitës ose në një mënyrë tjetër do të siguroj kthimin dhe ri përdorimin për të gjithë ambalazhin që e ka vendosur në treg.

2. Prodhuesi mban evidencë për llojin dhe sasinë e ambalazhit të nxjerr në treg, si dhe për sasinë e ambalazhit të ri përdorshëm të kthyer.

KAPITULLI III KUSHTET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE TË AMBALAZHIT DHE KËRKESAT PËR GRUMBULLIMIN, MAGAZINIMIN, PËRPUNIMIN DHE TRAJTIMIN E TYRE

Neni 11 Përpunimi, ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave të ambalazhit

1. Përpunimi, ripërdorimi, riciklimi dhe metodat tjera të trajtimit të ambalazhit mbeturinë, duhet të bëhet sipas parimit për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve i paraparë në nenin 5, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

2. Ministria përcakton objektivat për përpunimin dhe riciklimin në Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave dhe monitoron arritjen e tyre.

Neni 12 Detyrimet e shitësit

1. Shitësi duhet t'i vendosë kontejnerët ose pajisjet tjera për grumbullimin e ambalazhit mbeturinë.
2. Shitësi, ambalazhin mbeturinë të grumbulluar mund ta magazinonj përkohësisht në kuadër të hapësirës së vet punuese.

Neni 13 **Detyrimet e Operatorit**

1. Operatori i cili bënë trajtimin e ambalazhit dhe mbeturinave të tyre duhet të sigurojë:
 - 1.1. Grumbullimin dhe klasifikimin e ambalazhit dhe mbeturinave të tyre;
 - 1.2. Rishfrytëzimin, përpunimin ose magazinimin e ambalazhit dhe mbeturinave të tyre, të cilat janë grumbulluar dhe klasifikuar.
2. Operatori që merret me grumbullimin dhe trajtimin e ambalazhit dhe mbeturinat e tyre, përveç kushteve të planit të përcaktuar në nenin 11 dhe 12, të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, operatori duhet të përfshijnë në plan edhe informacionet për:
 - 2.1. Llojin e ambalazhit dhe mbeturinat e tyre për të cilat e bëjnë trajtimin;
 - 2.2. Llojin dhe kapacitetin e mjeteve dhe pajisjeve për grumbullim, klasifikim, magazinim, ndarje dhe aktivitete të tjera me prioritet për të siguruar ri shfrytëzimin, përpunimin ose magazinimin e ambalazhit dhe mbeturinave të tyre;
 - 2.3. Hapësirat dhe metodat e parapara për ri shfrytëzim, përpunim, magazinim ose riciklim të ambalazhit dhe mbeturinave të tyre të grumbulluara;
 - 2.4. Sasinë e përgjithshme të paraparë të ambalazhit dhe mbeturinave të tyre për grumbullim, përpunim ose riciklim, për llojet e caktuara të materialit të ambalazhit.

Neni 14 **Menaxhimi i grumbullimit të ambalazhit mbeturinë**

1. Prodhuesi i produkteve të ambalazuara dhe prodhuesi i ambalazheve që mbushen në pikën e shitjes apo persona të tretë që veprojnë në emër të tyre marrin masa që të financojnë të gjitha kostot, që rrjedhin për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kthimit dhe përpunimit të mbeturinave të ambalazhit, individualisht apo në bashkëpunim ndërmjet tyre.
2. Konsumatori hedh mbeturinat e ambalazheve në vendin e caktuar për dorëzimin e mbeturinave të ambalazheve nga subjekti i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni ose në vendet e përcaktuara nga Komuna.

3. Subjekti i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, me qëllim që të ruaj të padëmtuar cilësinë e mbeturinave të ambalazheve që shkojnë për ripërdorim apo riciklim, merr masat për transportimin me mjete të përshtatshme, të mbeturinave të ambalazheve.

4. Subjekti i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, mban evidencën për sasinë e mbeturinave nga ambalazhi sipas vëllimit ose peshës.

5. Subjektet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i dorëzojnë te operatori mbeturinat e ambalazhit për trajtim të tyre dhe mban evidencën për sasinë e mbeturinave e dorëzuara.

Neni 15

Grumbullimi i ambalazheve mbeturinë

1. Ambalazhi mbeturinë varësisht prej llojit, grumbullohet në kontejnerë ose në pajisje adekuate e cila duhet të përmbajë:

1.1. Shenjën e emërimit të llojit të ambalazhit;

1.2. Mënyrën e klasifikimit;

1.3. Të dhënat për personin juridik i cili bënë grumbullimin e mbeturinave nr. e tel. adresën, e-mail.

2. Personi i pajisur me leje përkatëse për grumbullim e mbeturinave komunale që grumbullon ambalazhin dhe mbeturinat e tyre prej letre dhe kartoni, në të njëjtin kontejner mund të grumbulloj edhe lloje të tjera të letrës mbeturinë, por nuk mund t'i klasifikoj si ambalazh mbeturinë.

Neni 16

Kontrata në mes të personit me leje përkatëse për trajtim të mbeturinave dhe prodhuesit

1. Personi i pajisur me leje përkatëse që trajton ambalazhin dhe mbeturinat e tyre me kompensim për grumbullim, magazinim, përpunim, trajtim ose riciklim, për kompensim duhet të ketë kontratë me prodhuesin e ambalazhës.

2. Prodhuesi po ashtu mund të lidh kontratë me personin me leje përkatëse që trajton ambalazhin dhe mbeturinat e tyre me kompensim për grumbullim, magazinim, përpunim ose riciklim.

3. Çmimi i trajtimit të ambalazhit mbeturinë bëhet sipas kushteve të përcaktuara me kontratë në mes të palëve.

Neni 17

Leja përkatëse mjedisore

1. Operatorët që menaxhojnë mbeturinat nga ambalazhi duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore.
2. Operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore që menaxhojnë mbeturinat nga ambalazhi, duhet të ketë hapësirë, magazinë dhe pajisje tjera me të cilat sigurohet trajtimi i ambalazhit.
3. Objekti dhe pajisja duhet të jenë të organizuara në mënyrë të përshtatshme për grumbullimin, klasifikimin, trajtimin dhe përgatitjen për transportimin.

Neni 18 **Eksporti i mbeturinave të ambalazhit**

Mbeturinat e ambalazhit eksportohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19 **Zbatimi i SRD-së**

1. SRD zbatohet për:

1.1. Produktin e SRD-së që përfshin pijen, duke përfshirë verërat dhe birrat, pavarësisht nëse gjendet dhe shitet si i vetëm në ambalazhin apo si njësi në një (1) ambalazh të shumëfishtë, që:

1.1.1. Është bërë nga shishe PET, kanaçe alumini, shishe qelqi;

1.1.2. Është projektuar që të përmbajë të paktën zeropikënjëzetepesë (0,25) litra lëng dhe jo më shumë se dy (2) litra lëng, dhe të jetë i mbyllur në gjendje hermetike dhe të papërshkueshme nga uji në pikën e shitjes;

1.1.3. Vendoset në treg, ofrohet për shitje ose për t'u shitur nga prodhuesi për qëllime të shitjes me pakicë në Kosovë.

1.2. Ambalazhin e SRD-së në të cilin gjendet ose shitet një produkt i SRD-së.

Neni 20 **Përjashtimet në SRD**

1. Nga SRD përjashtohen produktet dhe ambalazhi si në vijim:

1.1. Qumështi dhe produktet e qumështit;

1.2. Pijet e forta alkoolike;

1.3. Kavanozat e qelqit;

1.4. Kutitë prej kartoni -Tetra Pak.

2. Prodhuesi që vendos pije në treg në ambalazhe me vëllim vjetor të produkteve më pak se pesëmbëdhjetëmijë (15.000) litra, përjashtohen nga detyrimet e përcaktuara të SRD-së.

3. Shitësi që shet pije të ambalazuara me depozitë nuk është i detyruar të pranojë kthimin e ambalazhit me depozitë nëse sipërfaqja e shitjes është më pak se njëqindë (100) metra katrorë.

4. Depozita nuk do të vendoset në ambalazhin e pijeve për:

4.1. Ambalazhin e eksportuar, nëse eksporti është i vërtetuar me deklaratë doganore për eksport;

4.2. Ambalazhin i cili merret nga Republika e Kosovës për t'u vendosur në një shtet tjetër, ose në një anije ose aeroplan të angazhuar në udhëtime ndërkombëtare me qëllim të konsumimit të produkteve të shitura;

4.3. Ambalazhin me kapacitet më të madh se dy (2.0) litra dhe ambalazh me kapacitet më të vogël se zero pikë njëzetepesë (0.25) litra.

Neni 21

Objektivat e normës së kthimit në SRD

1. Objektivat e normës së kthimit për ambalazhet e pijeve në fushëveprimin e SRD-së që duhet të arrihen nga Administratori janë të paktën tetëdhjetë (80) % e numrit të produkteve të ambalazhit të SRD-së të vendosura në dispozicion për t'u tregtuar, ofruar për shitje ose shitur për qëllime të shitjes me pakicë në Kosovë nga ai prodhues, të bëra nga plastika PET, qelqi, ose alumini deri në vitin e tretë (3) që kur sistemi të jetë funksional.

2. Objektivat e normës së kthimit të SRD-së fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2025.

Neni 22

Administratori

1. Administratori është organizatë jofitimprurëse që ofron shërbime të interesit të përgjithshëm në Republikën e Kosovës.

2. Administratori përbëhet nga konsorcium i personave juridikë që përbëjnë të paktën nga një (1) prodhues, importues dhe shitës me pakicë të pijeve të ambalazuara që janë subjekt i SRD-së, të regjistruar në Republikën e Kosovës.

3. Administratori ushtron përgjegjësitë e përcaktuara nga ky Udhëzim Administrativ në lidhje me SRD-në në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe koordinon dhe administron SRD-në dhe bën barazimin e depozitave.

Neni 23

Aplikimi për Administrator

1. Ministria publikon thirrjen për themelimin e Administratorit së bashku me Udhëzuesin Praktik për të filluar procesin e vetëorganizimit për paraqitjen e aplikimit për themelimin e Administratorit.

2.Nga sektori privat dorëzohet një (1) aplikim i përbashkët për themelimin e Administratorit.

3.Aplikuesi për Administrator paraqet aplikimin brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve nga data e thirrjes publike. Së bashku me aplikimin, dorëzohen gjithashtu dokumentet e mëposhtme:

3.1.Plani biznesor që përfshin gjithashtu planin organizativ për SRD, së bashku me përshkrimin teknikë për funksionimin e tij;

3.2.Skema e financimit dhe mënyra e financimit të SRD-së;

3.3.Marrëveshja e konsorciumit sipas paragrafit 2 të Nenit 22 në mes të paktën një (1) prodhuesi, importuesi dhe shitësi me pakicë të pijeve të ambalazuara që janë subjekt i SRD-së, të regjistruar në Republikën e Kosovës;

3.4.draft Statuti i organizatës;

3.5.Plani për arritjen e objektivave të shkallës së grumbullimit për ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ;

3.6.Forma e kontratave të ardhshme ndërmjet Administratorit, prodhuesve, importuesve të ambalazheve dhe shitësve me pakicë të ambalazheve, duke specifikuar detajet për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij Udhëzimi Administrativ;

3.7.Plani i aktiviteteve ndërgjegjësuere, edukative dhe promovuese në lidhje me SRD;

3.8.Shënimi grafik i ambalazhit të pijeve që i nënshtrohen depozitimit;

4.Dokumente tjera mund të kërkohen nga Ministria në proces të aplikimit, bazuar në Udhëzuesin Praktik të publikuar me thirrjen.

Neni 24

Komisioni për shqyrtimin e aplikimit për Administrator

1.Aplikimi për Administrator shqyrtohet nga Komisioni i emëruar nga Ministri përkatës për Mjedis i përbërë nga pesë (5) anëtarë.

2.Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni, brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditë shqyrton nëse të gjitha dokumentet e përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 23 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe

në Udhëzuesin Praktik janë paraqitur si dhe bën shqyrtimin e përmbushjes së kritereve përkatëse për themelimin e Administratorit.

3.Nëse aplikimi është i pakompletuar, Komisioni informon palët përkatëse dhe cakton afatin kohor prej jo më shumë se tridhjetë (30) ditë për sqarimin ose plotësimin e Aplikimit dhe dokumenteve në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ dhe në pajtim me Udhëzuesin Praktik.

Neni 25

Miratimi Preliminar i Administratorit

1.Ministri nxjerrë vendim preliminar për miratimin e Administratorit për SRD në bazë të rekomandimit të Komisionit nga paragrafi 1 i nenit 24. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë.

2.Aplikuesi për Administrator bën kërkesë për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse në përputhje me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit për përzgjedhje.

Neni 26

Vendimi përfundimtar i miratimit

1.Pas përfundimit të procedurës së regjistrimit të Administratorit sipas paragrafit 2 të nenit 25, Aplikuesi pa vonesë dorëzon dokumentet e regjistrimit në Ministri.

2.Ministri miraton dokumentet e paraqitura të regjistrimit pas rekomandimit të Komisionit nga paragrafi 1 i nenit 24, të cilat së bashku me dokumentet e miratuara me vendimin preliminar, bëhen dokumente bazë të Administratorit.

3.Në vendimin përfundimtar specifikohet data nga e cila Administratori mund të fillojë të veprëjë sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ.

4.Nëse aplikuesi nuk paraqet kërkesën për regjistrim sipas paragrafit 2 të nenit 25 apo nuk dorëzon dokumentet e regjistrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, ose ato nuk plotësojnë kërkesat e specifikuar, Ministri tërheq aplikuesin e përzgjedhur për administrator dhe fillon procedurën e re të thirrjes për aplikim.

5.Pas miratimit të dokumenteve bazë, nëse është e domosdoshme dhe arsyeshme, ndryshimet në dokumentet bazë të administratorit mund të bëhen nga Ministri pas konsultimeve paraprake me administratorin.

Neni 27

Detyrimet e Administratorit

1. Administratori duhet të:

1.1. Krijojë, administrojë dhe financojë SRD-në, në përputhje me dokumentet bazë të Administratorit;

1.2. Njoftojë prodhuesit dhe shitësit e ambalazhit se ka filluar të funksionojë si Administrator dhe të lidhë kontrata me prodhuesit dhe shitësit me pakicë për të përmbushur detyrimet sipas këtij Udhëzimi Administrativ;

1.3. Sigurojë që objektivat e normës së kthimit për ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së, siç përcaktohet në këtë Udhëzim Administrativ, janë arritur;

1.4. Ofrojë shërbime për prodhuesit e dhe shitësit e ambalazhit me kushte jodiskriminuese;

1.5. Të zbatoj masat e përcaktuara në planin organizativ të SRD-së dhe në skemën e financimit;

1.6. Vendos lartësinë e tarifës së trajtimit;

1.7. Në përputhje me kontratat e lidhura, të rimburojë shitësit e ambalazhit për pagesat e bëra për rimbursimin e depozitave;

1.8. Rimburojë kostot e shitësve të ambalazhit që lidhen me grumbullimin e ambalazheve të pijeve që i nënshtrohen SRD-së në përputhje me kontratën e lidhur;

1.9. Informojë dhe ngrit vetëdijen e publikut për SRD-në;

1.10. Krijojë dhe të operojë sistemin e informacionit për SRD-në, të mbajë evidencë për ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së dhe të raportojë të dhënat në Agjenci;

1.11. Të paraqesë në Ministri një listë të përditësuar të prodhuesve, importuesve dhe shitësve të ambalazheve që kanë lidhur kontratë me Administratorin;

1.12. Gjatë aktiviteteve të tij, të veprojë me kujdesin e duhur profesional dhe në përputhje me interesat legjitime të prodhuesve, importuesve dhe shitësve me pakicë që janë nën kontratë me Administratorin;

1.13. Të lejojë ushtrimin e mbikëqyrjes të kryer sipas këtij Udhëzimi Administrativ dhe t'u sigurojë autoriteteve mbikëqyrëse informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve;

1.14. Miraton ose revokon një përjashtim për pikën e kthimit për shitësin me pakicë nëse i është bërë apo jo kërkesë;

1.15. Publikon dhe mban listën e prodhuesve, importuesve, shitësve me pakicë të regjistruar, si dhe shitësve me pakicë të cilëve u është miratuar përjashtimi.

Neni 28

Kërkesa për regjistrimin e prodhuesit dhe importuesit te Administratori

1. Administratori njofton me shkrim prodhuesit dhe importuesit se ka filluar të veprojë si Administrator brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga miratimi i dokumenteve bazë të Administratorit, dhe kërkon regjistrimin e prodhuesve dhe importuesve te Administratori.

2. Kërkesa për regjistrimin e prodhuesit dhe importuesit duhet t'i bëhet Administratorit brenda tridhjetë (30) ditëve që kur ai person të bëhet prodhues ose importues.

3. Në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i kërkesës, Administratori bën regjistrimin e aplikuesit, nëse kërkesa është në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ dhe vlerëson se aplikuesi i përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

4. Pas aprovimit të kërkesës, Administratori duhet që brenda shtatë (7) ditëve nga data e marrjes së kërkesës të njoftojë aplikuesin me shkrim.

5. Kur kërkesa refuzohet, Administratori duhet që brenda shtatë (7) ditëve nga data në të cilën është refuzuar kërkesa, të njoftojë me shkrim nëpërmjet vendimit duke dhënë arsyet e tij dhe deklaratën në lidhje me të drejtën e ankimit.

6. Nëse importuesi ose prodhuesi refuzon të regjistrohet në sistemin e rimbursimit të depozitës, zbatohet taksa prej zero pikë njëzeteshtatë (0.27) euro për litër të ambalazhit të pijës për atë importues ose prodhues.

Neni 29

Revokimi i regjistrimit të prodhuesit dhe importuesit

1. Administratori mund të revokojë regjistrimin e prodhuesit dhe importuesit në rast:

1.1. Të shkeljes se ndonjë detyrimi të përcaktuar në këtë Udhëzimin Administrativ;

1.2. Se prodhuesi, importuesi ose shitësi me pakicë me vetëdije ose nga pakujdesia ka dhënë informacione të rreme në lidhje me kërkesën për regjistrim ose respektim të ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;

1.3. Kur prodhuesi dhe importuesi pushojnë të veprojnë si prodhues ose importues.

2. Para revokimit të regjistrimit nga nën-paragrafi 1.1 i këtij neni, Administratori do t'i kërkojë subjektit të regjistruar që të korrigjojë shkeljen e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e njoftimit.

3. Nëse edhe pas afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, subjekti i regjistruar nuk e korrigjon shkeljen e konstatuar, Administratori do ta njoftojë subjektin e regjistruar me Vendim për revokimin i cili përmban arsyet e tij datën në të cilën revokimi hyn në fuqi dhe të drejtën për ankesë.

Neni 30 **Vlera e depozitës**

1. Vlera e depozitës do të jetë zero pikë zero pesë (0.05) euro për një ambalazh që është subjekt i SRD-së e cila përjashtohet nga TVSH.
2. Vlera e depozitës mund të ndryshohet me propozim të Ministrisë dhe miratim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në konsultim me Administratorin, por jo nën vlerën zero pikë zero pesë (0.05) euro. Propozimi shoqërohet me një analizë të arsyeshmërisë dhe ndikimit të ndryshimit të vlerës.
3. Depozita nuk përfshin koston e pranimin të kthimit të ambalazhit dhe mbeturinave të ambalazhit.
4. Vlera e depozitës nga shitja e ambalazhit me depozitë do të jetë e identifikueshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.
5. Një depozitë e paguar kthehet kur konsumatori dorëzon një ambalazh në sasi të arsyeshme në gjendje të kthyeshme në të cilën është vendosur depozita në vendin e shitjes së pijeve ose në një vend të përcaktuar për këtë qëllim në afërsi të tij.
6. Prodhuesi, importuesi dhe shitësi me pakicë duhet të sigurojnë që depozita e vendosur t'i shtohet çmimit të produktit të ambalazhuar në momentin e shitjes dhe që llogaritë të shlyhen pas çdo transaksioni të kthimit.

Neni 31 **Detyrimet e shitësve me pakicë për SRD-në**

1. Për të siguruar funksionimin e duhur të SRD-së, shitësit me pakicë të ambalazhit që shesin pije në ambalazhe që janë subjekt i depozitimit te konsumatorëve duhet:
 - 1.1. Të aplikojnë depozita për ambalazhin e pijeve dhe ti përmbahen vlerës së përcaktuar të depozitës;
 - 1.2. Në çmimin e shitjes së pijeve të ambalazhuara, të tregoj edhe shumën e depozitës nëse këto janë pije të ambalazhuara që janë subjekt i SRD-së;
 - 1.3. Të shfaqin qartë informacionin se si mund të shpaguehet një depozitë në rastin e një produkti të SRD-së, të tregtuar, të ofruar për shitje ose:

- 1.3.1. Të shitur në lokalet e shitësit me pakicë, në ato lokale;
 - 1.3.2. Të shitur me anë të shitjes me pakicë në distancë, në çdo vend ku produkti i skemës shfaqet për shitje;
 - 1.3.3. Të shitur me anë të një makine shitëse kthyese, në makinën shitëse kthyese.
 - 1.4. Të mbajnë shënime të veçanta kontabël për çmimin e pijeve dhe shumën e depozitës;
 - 1.5. Në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga marrja e njoftimit për fillimin e aktiviteteve të Administratorit , të kërkojë nga Administratori lidhjen e kontratës për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij Udhëzimi Administrativ;
 - 1.6. Të regjistrohen tek Administratori si një pikë kthimi për përmbajtjen e ambalazhit të pijeve që i nënshtrohen depozitimit;
 - 1.7. Të rimburojnë shumën e depozitës tek konsumatori kur ambalazh i pijeve që i nënshtrohen depozitimit kthehet në sasi dhe cilësi të arsyeshme;
 - 1.8. Të mbledhin ambalazhin e pijeve që i nënshtrohen SRD-së në vendin e vendosjes së tyre, ose brenda njëqindpesëdhjetë (150) metrave nga vendi i vendosjes së tyre pa kufizime sasiore.
2. Shitësit e ambalazhit të cilët i nënshtrohen SRD-së:
 - 2.1. Mbledhin ambalazhin e pijeve dhe mbrojnë atë nga dëmtimi, vjedhja ose rrjedhjet e padëshirueshme;
 - 2.2. Dorëzojnë tek Administratori ambalazhin e pijeve që janë subjekt i SRD-së.
 3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për objektet:
 - 3.1. Për të cilat është dhënë një përjashtim në përputhje me paragrafin 1 të nenit 34;
 - 3.2. Që janë një objekt eksporti;
 - 3.3. Ku shitja e një produkti të skemës në ato lokale bëhet vetëm me anë të automatit.

Neni 32
Pika e kthimit

1. Operatori i pikës së kthimit është çdo person që operon me një pikë kthimi, duke përfshirë shitësin me pakicë dhe operatorin e pikës së kthimit vullnetar.

2. Operatori i pikës së kthimit duhet:

2.1. Të pranojë një produkt të ambalazhit të SRD-së të kthyer në pikën e kthimit;

2.2. T'i paguajë konsumatorit një shumë të barabartë me depozitën për çdo produkt të ambalazhit të SRD-së;

2.3. Të ruajnë ambalazhin e SRD-së për grumbullim nga Administratori.

3. Operatori i pikës së kthimit duhet të shfaqë qartë informacionin në pikën e kthimit për:

3.1. Procedurën e ankesave dhe detajet e kontaktit për marrjen e çdo ankese që mund t'i bëhet atij operatori nga një konsumator në lidhje me funksionimin e pikës së kthimit; dhe

3.2. Të dhënat e kontaktit të Inspektoratit të Mjedisit.

4. Operator i pikës së kthimit mund të refuzojë të pranojë një produkt të ambalazhit nëse:

4.1. Nuk është i identifikueshëm si ambalazh i SRD-së;

4.2. Është i ndotur;

4.3. Nuk është bosh;

4.4. Operatori i pikës së kthimit ka kërkuar një grumbullim të ambalazhit të SRD-së nga prodhuesi ose Administratori dhe grumbullimi nuk është kryer në përputhje me planin operacional të atij prodhuesi ose Administratori; ose

4.5. Është pjesë e një kthimi të vetëm të propozuar nga konsumatori që përmban një numër produktesh të ambalazhit në mënyrë disproporcionale më të madhe se numri i produkteve të SRD-së që shitësi me pakicë shet, mesatarisht, si pjesë e një transaksioni të vetëm.

Neni 33 **Shërbimet kthyese**

1. Shërbim kthyes është një shërbim i ofruar nga shitësi me pakicë që mundëson një produkt të ambalazhit të SRD-së në të cilin gjendet produkti i SRD-së dhe shitet nga shitësi me pakicë një konsumatori, që të mblidhet nga ose në emër të atij shitësi nga vendi i dorëzimit për qëllimet e kthimit të tij te:

1.1. Shitësi me pakicë, përfshirë përmes pikës së kthimit; ose

1.2. Prodhuesi; dhe

- 1.3. Pagesës për atë konsumator të një shume të barabartë me depozitën për çdo produkt të ambalazhit të SRD-së së mbledhur dhe kthyer në këtë mënyrë.
2. Shitës me pakicë që ka shitur një produkt të SRD-së përmes një shitjeje me pakicë në distancë duhet të ofrojë një shërbim kthimi pa pagesë për konsumatorin që ka blerë produktin e SRD-së.
3. Shitësi me pakicë që ofron një shërbim kthyes mund të aplikojë një tarifë që nuk tejkalon koston e materialeve të përdorura në lidhje me grumbullimin dhe ruajtjen e ambalazhit të SRD-së, në varësi të kërkesës për të rimbursuar konsumatorin.

Neni 34 **Përjashtimet për pikat e kthimit**

1. Administratori mund të përjashtoj një shitës me pakicë nga detyrimi i përcaktuar në nenin 32 të këtij Udhëzimi Administrativ në lidhje me lokalet e shitjes me pakicë, në rastet kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

1.1. Kur ekziston një pikë alternative e kthimit e vendosur në afërsi të arsyeshme me lokalet dhe operatori i asaj pike të kthimit ka rënë dakord të pranojë kthimin nga konsumatorët e produkteve të ambalazhit të SRD-së në emër të shitësit me pakicë;

1.2. Administratori konsideron se, nëse pranohet përjashtimi, kjo do t'u sigurojë konsumatorëve qasje të arsyeshëm në një pikë të kthimit;

1.3. Nëse përjashtimi aprovohet, ai nuk do të dëmtojë ndjeshëm aftësinë e prodhuesit ose Administratorit të SRD-së në emër të tyre për të përmbushur objektivat e tyre të grumbullimit;

1.4. Kur Administratori është i bindur se lokacioni, plani, projektimi ose ndërtimi i lokaleve të shitjes me pakicë nuk lejon ose nuk mund të ndryshohet në mënyrë të arsyeshme për të mundësuar funksionimin e një pike të kthimit në lokalet pa rrezik të konsiderueshëm që shitësi të shkelë detyrimin ligjor në lidhje me ndonjë nga kërkesat e mëposhtme:

1.4.1. Siguria e ushqimit;

1.4.2. Shëndeti dhe siguria;

1.4.3. Siguria nga zjarri;

1.4.4. Mbrojtja e mjedisit;

1.4.5. Shëndeti publik.

2. Administratori duhet të publikojë dhe të mbajë një listë të shitësve me pakicë të cilëve u është dhënë përjashtimi.

3. Shitësi me pakicë të cilit i është dhënë përjashtimi duhet qartë të shfaqë informacionin në lokalitetin e shitësit me pakicë duke treguar së në bazë të përjashtimit të dhënë ata nuk operojnë me pikën e kthimit dhe njofton për pikën më të afërt të kthimit.

Neni 35

Kërkesa për përjashtimin e një pike të kthimit

1. Shitësi me pakicë mund t'i kërkojë Administratorit të përjashtohet si pikë e kthimit.
2. Kërkesa për përjashtim duhet:
 - 2.1. Të bëhet me shkrim;
 - 2.2. Të përmbajë informacione se lokacioni, plani, projektimi ose ndërtimi i ambienteve të shitjes me pakicë nuk lejon ose nuk mund të ndryshohet në mënyrë të arsyeshme për të mundësuar funksionimin e një pike të kthimit në lokacion pa rrezik të konsiderueshëm që shitësi të shkelë detyrimin ligjor në lidhje me ndonjë nga çështjet e cekura në nenin 34 të këtij Udhëzimi Administrativ; dhe
 - 2.3. Të përfshijë çdo informacion tjetër të kërkuar nga Administratori.
3. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës, Administratori mund ta pranojë kërkesën kur bindet se kushtet përkatëse në paragrafin 1 të nenit 34 të këtij Udhëzimi Administrativ, janë plotësuar.
4. Kur Administratori vendos të jap një përjashtim, ai duhet që brenda shtatë (7) ditëve nga data e këtij vendimi ta njoftojë me shkrim shitësin me pakicë për atë vendim dhe datën që përjashtimi hyn në fuqi.
5. Kur kërkesa refuzohet, Administratori duhet që brenda shtatë (7) ditëve nga data në të cilën ai është refuzuar, ta njoftojë me shkrim shitësit për atë vendim, së bashku me arsyet për këtë.

Neni 36

Revokimi i përjashtimit për një pikë të kthimit

1. Administratori mund të revokojë një përjashtim kur konsideron se:
 - 1.1. Ka pasur një ndryshim material në lidhje me ndonjë nga rrethanat në të cilat është miratuar përjashtimi;
 - 1.2. Në rastin e përjashtimit të dhënë në përputhje me nën-paragrafin 1.1, 1.2. dhe 1.3. të nenit 34 të këtij Udhëzimi Administrativ, mbajtja e përjashtimit nuk do t'u sigurojë më konsumatorëve qasje të arsyeshme në një pikë të kthimit;

1.3. Shitësi me pakicë nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas nën-paragrafit 1.4. të nenit 34 të këtij Udhëzimi Administrativ; ose

1.4. Shitësi me pakicë ka kërkuar që të revokohet përjashtimi.

2. Pas revokimit të përjashtimit, Administratori duhet t'i dorëzojë shitësit. Vendimin me arsyet për revokimin e tij dhe datën në të cilën revokimi hyn në fuqi.

Neni 37

Operatorët e pikave të kthimit vullnetar

1. Një person mund të operojë me një pikë të kthimit në një vend të ndryshëm nga mjedisi në të cilin duhet të funksionojë një pikë e kthimit, nëse ai është regjistruar te Administratori si operator i pikës së kthimit vullnetar.

2. Kërkesa për regjistrim duhet:

2.1. Të bëhet me shkrim;

2.2. Të përmbajnë informacionet e mëposhtme:

2.2.1. Emri, përfshirë emrin e biznesit, si dhe emrin personin që do të jetë operatori i pikës së kthimit;

2.2.2. Adresën dhe numrin e telefonit të aplikuesit;

2.2.3. Informacionin në lidhje me qasshmërinë e pikës së propozuar të kthimit duke përfshirë vendndodhjen fizike të saj, rrugët hyrëse në të dhe orarin e propozuar të punës;

2.2.4. Informacionin që tregon se aplikuesi ka burime të mjaftueshme për të ngritur dhe operuar pikën e kthimit për vitin e parë të funksionimit, numrin e produkteve të ambalazhit të SRD-së që aplikuesi pret t'i kthehen në një (1) muaj mesatar dhe si është llogaritur kjo, si dhe si aplikuesi synon të menaxhojë këtë vëllim të kthimeve;

2.2.5. Konfirmimin me shkrim që të gjithë prodhuesit e regjistruar kanë rënë dakord që aplikuesi mund të operojë pikën e kthimit në emër të tyre ose në rastin e prodhuesve të regjistruar nëpërmjet Administratorit të SRD-së.

3. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kërkesës, Administratori duhet ta miratojë kërkesën kur kërkesa është në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni ose ta refuzojë atë.

4. Kur kërkesa pranohet, Administratori duhet që, brenda shtatë (7) ditëve nga data në të cilën ajo është miratuar, të njoftojë me shkrim operatorin e pikës së kthimit vullnetar dhe datën kur hyn në fuqi.

5. Kur kërkesa pranohet, operatori i pikës së kthimit do të trajtohet si i regjistruar nga data e specifikuar në njoftimin e dhënë nga Administratori.
6. Administratori duhet të publikojë dhe mbajë një listë të pikave të kthimit vullnetar.
7. Kur kërkesa refuzohet, Administratori duhet, brenda shtatë (7) ditëve nga data në të cilën ajo është refuzuar, të njoftojë për atë vendim së bashku me arsyet për këtë.
8. Operatori i regjistruar i pikës së kthimit vullnetar duhet:
 - 8.1. Të respektojë detyrimet në nenin 34 të këtij Udhëzimi Administrativ; dhe
 - 8.2. Të njoftojë Administratorin për çdo ndryshim material në informacionin e dhënë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
9. Administratori mund të anulojë regjistrimin e operatorit të pikës së kthimit vullnetar nëse:
 - 9.1. Operatori nuk ka përmbushur detyrimet në paragrafin 8 të këtij neni;
 - 9.2. Ka pasur ndryshim material në informacionin e dhënë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni; ose
 - 9.3. Operatori i regjistruar i pikës së kthimit vullnetar ka kërkuar anulimin e regjistrimit të tij.
10. Pas anulimit të regjistrimit sipas paragrafit 9 të këtij neni, administratori duhet t'i dorëzojë operatorit të pikës së kthimit Vendimin me arsyet për anulimin e tij dhe datën në të cilën anulimi hyn në fuqi.

Neni 38
Tërheqja e miratimit të
Administratorit

1. Ministria i'a tërheq miratimin Administratorit nëse:
 - 1.1. Administratori ka shkelur ndonjë nga detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të këtij Udhëzimi Administrativ;
 - 1.2. Administratori ka dhënë informacion të rremë në lidhje me kërkesën për miratim ose përmbushje të ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të këtij Udhëzimi Administrativ;

- 1.3. Administratori është dënuar për vepër penale.
2. Para tërheqjes së miratimit, Ministria do të njoftojë me vendim me shkrim për tërheqjen e miratimit dhe arsyet për këtë, duke përfshirë hyrjen në fuqi dhe të drejtën e ankesës kundër këtij vendimi.
3. Ministria do të njoftojë të gjithë prodhuesit, importuesit dhe shitësit e regjistruar të SRD-së lidhur me vendimin.

Neni 39
Ankesat ndaj vendimeve të Administratorit

1. Administratori siguron që të krijohet dhe të jetë funksional një mekanizëm i brendshëm për shqyrtimin e ankesave për vendimet e tij për SRD-në.
2. Ndaj vendimeve përfundimtare të Administratorit, mund të ushtrohet ankesë në Ministri dhe zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KAPITULLI IV
INFORMIMI, MONITORIMI, MBIKËQYRJA DHE INSTRUMENTET EKONOMIKE

Neni 40
Informimi i përdoruesve të ambalazhit

1. Ministria në vazhdimësi merr masat e nevojshme që të njoftoj personat përgjegjës për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ dhe në mënyrë të veçantë, konsumatorët për:
 - 1.1. Sistemin e kthimit, grumbullimit dhe përpunimit për mbeturinat nga ambalazhet, përfshirë SRD-në në bashkëpunim me Administratorin;
 - 1.2. Pagesën që bën konsumatori për ambalazhet;
 - 1.3. Rolin dhe kontributin e tyre në grumbullimin e klasifikuar, ripërdorimin, përpunimin dhe riciklimin e ambalazheve dhe mbeturinave të tyre;
 - 1.4. Kuptimin e shenjave të ambalazheve që janë vendosur në treg;
 - 1.5. Rëndësinë e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 41
Raportimi i prodhuesëve dhe grumbulluesëve të ambalazhit dhe mbeturinave të ambalazhit

1. Sipas nenit 58 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, personat që merren me prodhimin dhe grumbullimin e ambalazhit dhe mbeturinat e tyre, janë të detyruar të raportojnë në Ministri për vitin e kaluar, deri me 31 Mars të vitit vijues.
2. Forma për raportim të ambalazhit të nxjerrë në treg është përcaktuar në Shtojcën IV, Formulari 1.
3. Forma për raportim për ambalazhin dhe mbeturinat e tyre e grumbulluar për përpunim dhe riciklim është përcaktuar në Shtojcën IV, Formulari 2.
4. Agjencia pranon raportin vjetor nga prodhuesit dhe grumbulluesit e ambalazhit, bën analizimin dhe vlerësimin e të dhënave, si dhe harton raportin përfundimtar për llojet e ambalazhit dhe mbeturinat e tyre të trajtuara.

Neni 42

Raportimi për qeset e plastikës

1. Prodhuesit e qeseve plastike i dërgojnë Agjencisë raport më së largu deri me datë 31 mars të vitit vijues, për numrin e qeseve të prodhuara në vitin paraprak, në formën e përcaktuar nga Agjencia.
2. Dogana e Kosovës deri më 31 Mars të vitit vijues i dërgon raport Agjencisë për numrin e qeseve të importuara në vitin paraprak.
3. Administrata Tatimore i dërgon raport Agjencisë për numrin e qeseve plastike të shitura për vitin paraprak, nëse me kërkesë i kërkohet nga Agjencia.
4. Agjencia do të krahasoj të dhënat e pranuar dhe përmes analizës vlerëson arritjen e objektivave për reduktimin e përdorimit të qeseve të plastikës mbajtëse me peshë të lehtë të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 43

Monitorimi dhe raportimi për SRD-në

1. Ministria monitoron Administratorin për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 27, përfshirë:
 - 1.1. Përmbushjen e objektivave të grumbullimit në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ;
 - 1.2. Sigurimin e vendosjes së tarifës së saktë të prodhuesit;
 - 1.3. Sigurimin që prodhuesit janë regjistruar siç duhet;

1.4. Sigurimin që Administratori i SRD-së ka dorëzuar raportin në Agjenci. Raporti duhet të përfshijë të dhëna për ambalazhet e pijeve të mbledhura që janë subjekt i SRD-së, dhe të dhëna tjera që kërkohen me këtë Udhëzim Administrativ.

1.5. Sigurimin e ofrimit të duhur të pikave të kthimit;

1.6. Sigurimin e grumbullimit ose asgjësimit të materialit në përputhje me SRD-në.

2. Administratori dorëzon raportin e auditimit të performances së paku në baza vjetore tek Agjencia. Auditimi kryhet nga një auditor i pavarur i certifikuar, i zgjedhur nga Administratori.

Neni 44 **Mbikëqyrja inspektuese**

1. Mbikëqyrjen inspektuese për ambalazhin dhe mbeturinat e tyre sipas kërkesave të këtij Udhëzimi Administrativ dhe lejes mjedisore përkatëse, e bën Inspektorati Mjedisor i Ministrisë dhe Inspektorati Komunal në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat dhe Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

2. Inspektorati Mjedisor i Ministrisë mbikëqyr prodhuesit për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ që përfshin:

2.1. Sigurimin që prodhuesit janë regjistruar te Administratori dhe paguajnë tarifën e regjistrimit;

2.2. Sigurimin që ambalazhi që është subjekt i SRD-së, i vendosur në treg është i regjistruar tek Administratori;

2.3. Sigurimin që prodhuesit të paguajnë shumën e depozitës tek Administratori;

2.4. Sigurimin që prodhuesit të shtojnë çmimin e depozitës së ambalazhit të vendosur në treg;

2.5. Sigurimi që produktet e vendosura në treg janë të shenjëzuara qartë sipas kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ;

2.6. Detyrimet raportuese për produktet e vendosura në treg janë përmbushur.

3. Kontrolli i pajtueshmërisë së ambalazhit të importuar me kërkesat e këtij Udhëzimi Administrativ sigurohet nga Dogana e Kosovës.

4. Mbikëqyrjen inspektuese të përmbushjes së detyrimit të shitësve me pakicë të ambalazhit të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ e bën Inspektorati i Tregut, që përfshin:

4.1. Sigurimin që shitësit me pakicë të detyrohen të pranojnë kthimet e ambalazheve të pijeve duke krijuar një pikë kthimi dhe se ata janë në përputhje me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë;

4.2. Sigurimin që çmimi i kostos dhe çmimi i depozitimit të ambalazhit të pijeve brenda fushëveprimit shfaqet qartë;

4.3. Sigurimi që shenjzimi i nevojshëm i SRD-së është i dukshëm në ambiente, duke përfshirë kur shitësi me pakicë është përjashtuar nga pranimi i kthimit të ambalazhit të pijeve;

4.4. Të mbajë shënime për të dhënat e raportuara në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ.

5. Administrata Tatimore e Kosovës kontrollon regjistrimin e shitjeve të ambalazhit në kuponin fiskal për konsumatorin dhe në regjistrat përkatës.

Neni 45 Instrumentet ekonomike

1. Ministria përkatëse për Mjedis përmes tarifës për reduktimin dhe riciklimin e qeseve të plastikës mbështet sektorin privat për projektet lidhur me reduktimin dhe riciklimin e qeseve të plastikës.

2. Përdoruesit e ambalazheve dhe produkteve të ambalazhuara, si dhe prodhuesit ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre përdorin instrumente ekonomike që nxitin zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ si taksa produkti, taksa kompensimi etj. dhe akteve të tjera ligjore.

3. Prodhuesit e ambalazheve dhe produkteve të ambalazhuara dhe persona të tretë, që veprojnë në emër të tyre, përdorin instrumente ekonomike sisteme të kompensimit të pagesave etj., që nxitin:

3.1. Grumbullimin e mbeturinave nga ambalazhet;

3.2. Përdorimin e materialeve ambalazhuese që nuk përmbajnë substanca të rrezikshme.

KAPITULLI V DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 46 Dispozitat ndëshkimore

1. Çdo person fizik ose juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, është përgjegjës dhe ndëshkohet sipas nenit 70, 71, 73 ose 74 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit përkatës për Tregtinë e Brendshme dhe ligjet përkatëse tatimore, varësisht nga shkelja e konstatuar.

2. Për shkeljen e dispozitave nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç sanksionit të përcaktuar, mund të ndërmerren edhe masa e sekuestrimit dhe konfiskimit të pajisjeve për prodhimin e ambalazhit dhe produktet, gjegjësisht ambalazhi i vendosur në treg, apo edhe masat e përcaktuara në nenin 72 të

Ligjit Nr. 04 /L-060 për Mbeturina dhe nenit 48 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 47 Dispozitat kalimtare

1. Masat dhe kërkesat për shenjzimin e qeseve të plastikës mbajtëse me peshë të lehtë nga paragrafi 1, 3 dhe 4 të nenit 6 dhe neni 8 fillojnë të zbatohen një muaj pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ.

2. SRD fillon të zbatohet nga data 1 janar 2025.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Ministria përgatit Udhëzuesin Praktik dhe fillon procesin e caktimit të Administratorit.

Neni 48 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 27/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ambalazhet dhe Paketimet.

Neni 49 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

25 gusht 2023

SHTOJCA I

LISTA ME SHEMBUJ ILUSTRUES PËR KRITERET E REFERUARA NË NENIN 3, NËN-PARAGRAFI 1.1.4 TË KËTIJ UDHËZIMI ADMINISTRATIV

Shembuj ilustrues për kriterin 1.1.4.1

Ambalazh

- Kutitë për ëmbëlsira;
- Shtresë e hollë për mbështjelljen e kutisë së CD-së;
- Zarfe të posaçme për katalogë dhe revista (me një revistë brenda);
- Dantella të tortës që shiten bashkë me tortë;
- Rollne, tuba dhe cilindra rreth materialit fleksibël-elastik (p.sh. shtresa plastike, alumin, letër) mbështillet, përveç rrollneve, tubave dhe cilindrave të destinuara si pjesë e makinerive të prodhimit dhe që nuk përdoren për të paraqitur një produkt si njësi e shitjes;
- Vazot e luleve për qëllim të përdorimit vetëm për shitjen dhe transportimin e bimëve dhe që nuk destinohen të qëndrojnë me bimën gjatë gjithë kohës së jetëgjatësisë së tyre;
- Shishe qelqi për solucionet e injeksionit;
- Mbajtës për CD (që shiten me CD, nuk janë të destinuar për t'u përdorur si ruajtje);
- Varëse rrobash (që shiten me një produkt të veshmbathjeve);
- Kutitë shkrepësesh;
- Sistemet e barrierave sterile (zarfe, tabaka dhe materialet e nevojshme për të ruajtur sterilitetin e produktit);
- Kapsula të sistemit të pijeve (p.sh. kafe, kakao, qumësht), të cilat kanë mbetur bosh pas përdorimit;
- Cilindra rimbushës prej çeliku që përdoren për lloje të ndryshme të gazit, duke përjashtuar aparatet për shuarjen e zjarrit.

Jo-ambalazhuese

- Vazo të luleve të destinuara për të qëndruar me bimën (lulen) gjatë gjithë jetëgjatësisë së saj;
- Kutitë mjeteve;
- Filtër çaji;
- Shtresa dylli rreth djathit;
- Mbështjellës suxhuku;
- Varëse rrobash (shiten ndarazi);
- Kapsula e sistemit të pijeve të kafes, ambalazh i kafes, dhe filtër kafe prej letre I hedhur me produktin e përdorur të kafes;
- Tonerë për printerë;

- Kutitë CD, DVD dhe Video (që shiten së bashku me CD, DVD ose me video kasetë brenda);
- Mbjajtëse të CD-ve (që shiten bosh, të destinuara për t'u përdorur si ruajtje);
- Qese të tretshme për detergjente;
- Drita skaj varresh (mbajtës për qirinj);
- Mulli dore mekanik (të integruar në një marrës rimbushës, p.sh. mulli rimbushës me piper).

Shembuj ilustrues për kriterin 1.1.4.2

Ambalazhi, nëse projektohet dhe destinohet për t'u mbushur në pikën e shitjes

- Qese prej letre ose plastike;
- Pjata dhe filxhanë për një përdorim;
- Foli e hollë;
- Qese për sandviç;
- Foli (petë) prej alumini;
- Foli (petë) plastike për rrobat e pastruara në lavanderi (pastrim kimik).

Jo-amabazhuese

- Mjet për përzierje (llokoçitje);
- Takëm (set) pirun, lugë, thika etj për një përdorim;
- Letër ambalazhi (që shiten ndarazi);
- Mbjajtëse prej letre e pjekurinave (shiten bosh);
- Dantella për tortë që shiten pa tortë.

Shembuj ilustrues për kriterin 1.1.4.3

Ambalazhi

- Etiketa që vendoset drejtpërsëdrejti në produkt ose bashkëngjitur një produkti.

Pjesë të ambalazhit

- Furçë bojë për vetulla që është pjesë e mbylljes së mbajtësit (kapakut) të saj;
- Etiketat ngjitëse bashkëngjitur në një tjetër produkt të ambalazhit;
- Kapëse;
- Foldera plastikë;
- Mjete për matjen e dozës që bën pjesë në mbylljen e mbajtësit për detergjente;
- Mulli dore mekanik (i integruar në një marrës jo-rimbushës, i mbushur me një produkt, p.sh. mulli piperi i mbushur me piper).

Jo-ambalazhuese

- Etiketat për identifikimin e radio frekuencave (RFID).

SHTOJCA II

KËRKESAT PËR PËRBËRJEN DHE NATYRËN E AMBALAZHIT, RIPËRDORIMIN DHE PËRPUNIMIN E TIJ, DUKE PËRFSHIRË EDHE RICIKLIMIN

1. Kërkesat të cilat në veçanti i përkasin përbërjes dhe përpunimit të ambalazhit:

- a) Ambalazhi duhet të prodhohet në mënyrë që vëllimi dhe pesha e ambalazhit të kufizohet në madhësinë minimale për të mbajtur sigurinë e duhur, higjienën dhe vëmendjen e konsumatorëve ndaj prodhimeve të ambalazuara;
- b) ambalazhi duhet të jetë i dizajnuar, prodhuar dhe i komercializuar në atë mënyrë që të mund të ripërdoret ose përpunohet duke përfshirë riciklimin, në përputhje me hierarkinë e mbeturinave, dhe të zvogëlohet ndikimi në mjedis kur mbeturinat e ambalazhit ose mbeturinat e ambalazhit krijohen gjatë menaxhimit të mbeturinave të ambalazhit;
- c) ambalazhi duhet të prodhohet ashtu që prania e substancave të dëmshme dhe materialeve që konstituojnë materialin e ambalazhit, të zvogëlohen në minimum me praninë e tyre në emision dhe hi, kur ambalazhi ose mbeturinat e tij, pas aktiviteteve menaxhuese djegën ose groposen.

2. Kërkesat që kanë të bëjnë me ripërdorimin e ambalazhës

Kërkesat në vijim duhet të plotësohet njëkohësisht:








- a) përbërja fizike e ambalazhit dhe karakteristikave të ambalazhit duhet të mundësojnë një numër rrotullimesh ose lëvizjesh në kushte normale të parashikueshme të përdorimit;
- b) mundësia e përpunimit të ambalazhit të shfrytëzuar ashtu që të përmbush kërkesat e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve;
- c) plotësimi i kërkesave specifike të ambalazhit i cili mund të përpunohet kur ambalazhi nuk mund të ripërdoret më dhe bëhet mbeturinë.

3. Kërkesat që kanë të bëjnë me natyrën e përpunimit (riciklimit) të ambalazhit

- a) Ambalazhi i cili mund të ripërdoret si material për riciklim
Ambalazhi duhet të prodhohet në mënyrë që të mundësohet riciklimi i një përqindjeje të peshës së materialit të shfrytëzuar për prodhimin e produkteve për treg , në harmoni me Standardet e BE-së. Përcaktimi i kësaj përqindje mund të ndryshoj, varësisht nga lloji i materialit që e përben ambalazhin.
- b) Ambalazhi i cili mund të përpunohet në formë të kthimit të energjisë
Mbeturinat e ambalazhit të përpunuar në formën e kthimit të energjisë duhet të kenë vlerën minimale kalorike që kthimi i energjisë të mundësohet në mënyrë optimale.
- c) Ambalazhi i cili mund të përpunohet me kompostim
Mbeturinat e ambalazhit të përpunuar në formë kompostimi, duhet të jenë të natyrës bio degraduese që nuk do të pengojë grumbullimin e ndarë dhe mënyrën e kompostimit ose aktivitetin për të cilin është shfaqur.
- d) Ambalazhi bio degradues
Ambalazhi mbeturinë bio degradues duhet të jetë i natyrës që t'i përballojë zbrërthimet fizike, kimike, termale ose biologjike, ku pjesa me e madhe e kompostit të gatshëm në fund të ndahet në dioksid karboni, biomasë dhe ujë. Plastika e okso-degradueshme nuk duhet të konsiderohet si biodegraduese.

SHTOJCA III
SHENJËZIMI DHE SHKURTESAT NË AMBALAZH

1. Shenjëzimi në ambalazhin nga plastika më së shumti gjenden në fund të enës

1.	Polietilen tereftalat (PET ose PETE)	
2.	Densitet i lartë i polietilenit (HDPE).	
3.	Polivinil kloruri (PVC)	
4.	Densitet i ulët i polietilenit (LDPE)	
5.	Polipropileni (PP)	
6.	Polistireni (PS)	
7.	Të tjera	

2. Shenjëzimi në ambalazhin nga letra dhe kartoni

Materiali	Shkurtesa	Shenja numerike
Ngjitjet valore (kartoni)	PAP	20
Ngjitjet e drejta (karton)	PAP	21
Letër	PAP	22

3. Shenjëzimi në ambalazhin nga metali

Materiali	Shkurtesa	Shenja numerike
Çelik	FE	40
Alumin	ALU	41

4. Shenjëzimi në ambalazhin nga druri

Materiali	Shkurtesa	Shenja numerike
Druri	FOR	50
Tapë	FOR	51

5. Shenjëzimi në ambalazhin nga tekstili

Materiali	Shkurtesa	Shenja numerike
Pambuk	TEX	60
Juta	TEX	61

6. Shenjëzimi në ambalazhin nga qelqi

Materiali	Shkurtesa	Shenja numerike
Qelqi pa ngjyrë	GL	70
Qelq i gjelbër	GL	71
Qelqi i kaftë	GL	72
Qelqi me ngjyrë tjetër	GL	73




7. Shenjëzimi në ambalazhën shumështrësore

Materiali	Shkurtesa*	Shenja numerike
Letër dhe karton/metale të ndryshme		80
Letër karton/plastikë		81
Letër karton/alumin		82
Letër dhe karton/llamarinë çeliku		83
Letër dhe karton/plastikë/alumin		84

Letër dhe karton/plastikë/alumin/ llamarinë çeliku		85
Plastikë/alumin		90
Plastikë/llamarinë e bardhë		91
Plastikë/metale të ndryshme		92
Qelq/plastikë		95
Qelq/alumin		96
Qelq/llamarinë e bardhë		97
Qelq/metale të ndryshme		98

*Shkurtesat shkruhen vetëm me shkronja të mëdha

8. Shenjëzimet për materialet

Riciklohen	Ripërdoren	E ricikluar
		

SHTOJCA IV.**Tabela 1.**

LLOJI I PRODHIMIT	Planifikimi i sasisë së ambalazhit kthyesë I shprehur në % për vit.		
Qelq			
Metal (kanaqe)			
Letër dhe karton			
Plastikë			
Dru			
Ambalazh prej materialeve tjera			

Formulari 1.

1. Të dhënat për ambalazhin e nxjerrë në treg: _____ datë					
2. Të dhënat për prodhuesin/ ambalazhuesin		Kompania:			
		Personi kontaktues :			
		Tel/Fax:			
		Adresa:			
Numri i regjistrimit të firmës tregtare					
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është nxjerrë në treg					
Lloji i materialit të ambalazhit	Përmbajtja e metaleve të rënda mg/kg	Sasia e nxjerrë në treg (kg)	Sasia e ambalazhit të nxjerrë në treg – njësia e ambalazhit shitës (copë).	Sasia e ambalazhit e:	
				Eksportuar	Importuar
3.1. Qelq					
3.2. Metal					
3.3. Letër- karton dhe ambalazh shumështrësor i përbërë prej letre					
3.4. Plastikë					
3.5. Dru					
3.6. Ambalazh prej materialeve tjera					
4. Personi përgjegjës për të dhënat: _____					
Udhëheqësi: _____					

Formulari 2.

1. Të dhënat për ambalazhin grumbulluar për përpunim dhe riciklim Raportimi për vitin _____ . Ambalazhin e lëshuar në treg: _____ datë					
2. Të dhënat për prodhuesin/ ambalazhuesin		Kompania:			
		Personi kontaktues :			
		Tel/Fax:			
		Adresa:			
		Numri i regjistrit të firmës tregtare			
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit					
Lloji i materialit të ambalazhit	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg)	Sasia e dorëzuar te përpunuesi (kg)		Sasia e eksportuar nga Kosova (kg)	Përpunuesi
		Sasia për riciklim (kg)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg)		
3.1. Qelq					
3.2. Metal					
3.3. Letër- karton dhe ambalazh shumështrësor i përbërë prej letre					
3.4. Plastikë					
3.5. Dru					
3.6. Ambalazh prej materialeve tjera					
4. Materiali i bashkëngjitur i argumentuar (të paraqiten dëshmi): _____					
5. Personi përgjegjës për të dhënat : _____ Udhëheqësi _____					